



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 927 Prot.

Durrës, më 31.5.2023

VENDIM

Nr 31, datë 31.5 2023

**"PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR 6 DATË 01.02.2023 "PËR MIRATIMIN E
DETAJIMIT TË PËRDORIMIT TË TË ARDHURAVE TË VITIT 2023 PËR
UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"**

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", zbatim të ligjit nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor", VKM nr.243, datë 20.04.2023 "Për disa ndryshime në VKM nr.748, datë 11.06.2009 "Për trajtimin me page dhe shtësa mbi page të punonjësve të personelit akademik të institucioneve të arsimit të lartë", të nenit 14 pika 2 të Rregullores Financiare të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Udhëzimit të përbashkët të MASR dhe MFE nr. 20, datë 20.09.2019, Vendimit nr. 51, datë 08.09.2022 të Senatit Akademik "Për miratimin paraprak të PBA 2023-2025", Vendimit nr. 41, datë 14.09.2022 të Bordit të Administrimit "Për miratimin e PBA 2023-2025", Rregulloren Financiare të UAMD, vendimit të Senatit Akademik nr.7, datë 26.01.2023, vendimit të Senatit Akademik nr.8, datë 26.01.2023, vendimit të Bordit të Administrimit nr.6, datë 01.02.2023, vendimit të Bordit të Administrimit nr.7, datë 01.02.2023, vendimit të Bordit të Administrimit nr.30, datë 19.05.2023, relacioni i Administratorit nr.861/1, datë 24.05.2023, vendimit të Senatit Akademik nr. 31, datë 26.05.2023, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të ndryshojë vendimin nr.6, datë 01.02.2023 mbi "Miratimin e detajimit të përdorimit të të ardhurave të vitit 2023, për Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, sipas tabelës së ndryshuar bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Tabela bashkëlidhur vendimit të Bordit të Administrimit nr.6, datë 01.02.2023, zëvendësohet me tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ky ndryshim do të reflektohet në tabelën përmbledhëse të Vendimit të Bordit të Administrimit nr.5, datë 01.02.2023.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori
 - Drejtoria e Administrimit Financiar

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

